



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE

Nr.11/17 Prot.

Tiranë më 26/01/2023

V E N D I M

Nr. 06 datë 26.01.2024

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Arben Sefaj
Denisa Sina
Suela Bulku

Kryesues
Relator
Anëtar

në datën 26.01.2024, në orën 09:30, në ambientet e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

SUBJEKTI I VLERËSIMIT:

Z. Luan Rakip Arifaj, me funksion ish Drejtor, në Drejtorinë Vendore të Kufirit dhe Migracionit, Durrës, me funksion aktual, Shef Sektori në Sektorin për Hetimin e Krimeve ndaj Personit, në Drejtorinë për Hetimin e Krimeve të Rënda, në Departamentin e Policisë Kriminale, në DPPSH.

OBJEKTI:

Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Ligji nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoji dhe vlerësoi shpjegimet dhe argumentimin ligjor të Relatorit të çështjes, Znj. Denisa Sina, si dhe pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni përgjegjës për kryerjen e procesit të vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, bazuar në Ligjin nr.12/2018, *“Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”*, i ndryshuar.
2. Subjekti i vlerësimit kalimtar, Luan Rakip Arifaj, ka dorëzuar *deklaratën e pasurisë, deklaratën e kontrollit të figurës dhe formularin e vlerësimit të aftësive profesionale*, për funksionin “Drejtor, në Drejtorinë Vendore të Kufirit dhe Migracionit, Durrës”, sipas përcaktimeve të neneve 32 pika 2, 36 pika 1, dhe 44 pika 1, të Ligjit nr.12/2018, *“Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”*, i ndryshuar.
3. Bazuar në nenin 6, të Ligjit nr.12/2018 *“Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”*, i ndryshuar, Luan Arifaj ka qenë subjekt i vlerësimit kalimtar nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit që mbante në datën e hedhjes së shortit, si “Drejtor, në Drejtorinë Vendore të Kufirit dhe Migracionit, Durrës”. Subjekti i vlerësimit, Luan Arifaj, iu nënshtrua procedurës së shortimit, në shortin e zhvilluar në datën 05.04.2023, nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.07, datë 17.01.2023 *“Për Procedurat e Hedhjes së Shortit”*. Sipas shortit të zhvilluar, Trupa e Vlerësimit përbëhet nga Z.Arben Sefaj (Kryesues), Znj. Denisa Sina (Relatore) dhe Znj.Suela Bulku (Anëtar).
4. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e Trupës së Vlerësimit, sipas nenit 27, pika 1 të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar dhe neneve 30 dhe 31, të Kodit të Procedurave Administrative.
5. Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar si edhe në bazë të Rregullores nr. 197, datë. 28. 02. 2023, *“Për hapat proceduralë të unifikuar”*, vendosi me Vendimin nr.1, datë 18.04.2023, fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Luan Arifaj, si dhe të caktojë Kryesues të Trupës Vlerësuese Z.Arben Sefaj.
6. Relatori i çështjes, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar të datës 18.04.2023, njoftoi subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar duke i bërë të njohur

përbërjen e Trupës së Vlerësimit, dhe duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.

7. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, “Deklaratën për Konfliktin e Interesit” me nr. *** prot. datë 24.04.2023, duke shprehur se, nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.
8. Relatori i çështjes, në përmbushje të detyrave ligjore të përcaktuara në pikën 3, të nenit 25, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, dhe sipas:
 - nenit 7, pika 1, të Rregullores nr. 197, datë 23.02.2023, “Për hapat proceduralë të unifikuar”, nenit 4, të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore dhe Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit, ka dërguar me shkresën nr.*** prot., datë 19.04.2023 , pranë ILDKPKI-së, formularin e deklarimit të pasurisë për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit .
 - nenit 7, pika 7, të Rregullores nr. 197, datë 23.02.2023, “Për hapat proceduralë të unifikuar”, ka dërguar me shkresën nr.*** prot., datë 19.04.2023, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, formularin e aftësive profesionale për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit.
 - nenit 7, pika 4, të Rregullores nr. 197, datë 23.02.2023, “Për hapat proceduralë të unifikuar”, ka dërguar me shkresën nr.*** prot., datë 19.04.2023, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, deklaratën e kontrollit të figurës për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit.
9. Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, ka informuar Trupën e Vlerësimit në lidhje me Urdhërin nr ***, datë 15.12.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për transferimin dhe emërimin në detyrë, të një punonjësi policie”, të Z.Luan Arifaj.
10. Në vijim, Relatori i çështjes, njoftoi për ndërprerje të procesit të hetimit administrativ për subjektin e vlerësimit, Z. Luan Rakip Arifaj.

II. ARSYETIMI LIGJOR I TRUPËS SË VLERËSIMIT

11. Në zbatim të Ligjit nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, sipas nenit 3, pika 18 e tij, “subjekt vlerësimi” janë punonjësit sipas përcaktimeve të bëra në pikat 15,16 dhe 17, të këtij neni.
12. Subjekti i vlerësimit, Z.Luan Arifaj, është transferuar dhe emëruar në një funksion tjetër, dhe ky vendim është formalizuar gjatë fazës së hetimit administrativ. Në këto kushte, gjendemi përpara faktit të përjashtimit nga fusha e veprimtarisë së Trupës së Vlerësimit, sipas përcaktimeve të nenit 6 të ligjit 12/2018, i ndryshuar.
13. Sa më sipër, Trupa e Vlerësimit deklaroi të përfunduar çështjen e hetimit administrativ të nisur ndaj subjektit të vlerësimit, pa një vendim përfundimtar për shkak se interesi, qëllimi dhe objekti për të cilin ka nisur procedura janë bërë ligjërisht të pamundur, duke konstatuar se ndodhet në kushtet e zbatimit të nenit 95, të Kodit të Procedurës Administrative.

PËR KËTO ARSYE

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, mbështetur në Ligjin nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, si dhe në nenin 95, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë;

V E N D O S I:

1. Ndërprerjen e procesit të vlerësimit kalimtar të subjektit të vlerësimit **Luan Rakip Arifaj**, me funksion ish-Drejtor, në Drejtorinë Vendore të Kufirit dhe Migracionit, Durrës, pa një vendim përfundimtar.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi, lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall sot datë 26.01.2024, në Tiranë.

TRUPA E VLERËSIMIT

Arben SEFAJ

Kryesues

Denisa SINA

Relator

Suela BULKU

Anëtar